

VENDIM
Nr.272, datë 7.5.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT, PËR HEQJEN E PJESSHME TË VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për heqjen e pjesshme të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT PËR HEQJEN E PJESSHME TË VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federative të Brazilit, më poshtë të quajtura “Palë”,
të frymëzuara nga dëshira për të lehtësuar, reciprokisht, hyrjen, kalimin transit dhe qëndrimin e shtetasve të tyre midis të dy vendeve,
ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e dy vendeve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, janë të përjashtuar nga viza e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit në territorin e Palës tjetër për një periudhë jo më gjatë e 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Neni 2

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, të cilët janë emëruar si pjesëtarë të një misioni diplomatik apo konsullor në territorin e Palës tjetër, do të lejohen të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër gjatë kohës së detyrës së tyre pa pasur nevojë të marrin vizë.

Neni 3

Dispozitat e nenit 2 zbatohen gjithashtu për familjarët e shtetasve të përmendur më lart, ashtu si dhe për personat e varur prej tyre, të cilët i shoqërojnë ata gjatë përdorimit në territorin e Palës tjetër dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare apo të shërbimit.

Neni 4

Mbajtësit e pasaportave të secilës Palë, të përmendur në nenet 1 deri në 3, mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër në të gjitha pikat e hapura për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve.

Neni 5

1. Palët do të shkëmbejnë në rrugë diplomatike modelet e pasaportave të tyre diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rastin kur çdonjëra nga Palët do t'i modifikojë këto pasaporta, ajo do t'i përcjellë Palës tjetër modelet e pasaportave të reja, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara se ato të hyjnë në përdorim.

Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk paragjykon të drejtën e çdonjërës Palë që të refuzojë hyrjen ose të shkurtojë qëndrimin e shtetasve të Palës tjetër, atëherë kur ajo vlerëson se prania e këtyre personave në territorin e saj është e padëshirueshme.

Neni 7

Për arsye sigurie të rendit publik apo të shëndetit publik, çdonjëra nga Palët mund ta pezullojë përkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në tërësi ose pjesërisht. Ky pezullim do t'i njoftohet Palës tjetër përmes kanaleve diplomatike, sa më parë të jetë e mundur.

Neni 8

1. Shtetasit e të dy Palëve që përfitojnë nga kjo Marrëveshje nuk përjashtohen nga respektimi i ligjeve dhe i rregullave në fuqi në të dy Palët, të cilat kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve dhe ata nuk do të kenë të drejtën të punësohen apo të zhvillojnë veprimtari fitimprurëse të çdo lloj natyre gjatë qëndrimit të tyre.

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në ligjet dhe rregullat përkatëse që kanë të bëjnë me hyrjen, daljen, kalimin transit dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar, përderisa njëra nga Palët ta denoncojë atë përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi do të bëhet i vlefshëm 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së këtij njoftimi.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e notës së dytë diplomatike, me anë të së cilës njëra Palë njofton tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e legjislacionit përkatës kombëtar që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

Bërë në Brazilia, në datën 23 mars 2004, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, portugeze dhe angleze, secila e vlefshme në mënyrë të barabartë.

Në rast mosmarrëveshje për interpretimin, do të jetë i vlefshëm teksti në anglisht.